



REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

DITARI MUJOR

JANAR 2024



Investimet në Universitetin Bujqësor të Tiranës

Në Universitetin Bujqësor të Tiranës ka përfunduar rindërtimi i godinës së Fakultetit të Bioteknologjisë së Ushqimit dhe Klinikës Veterinare, një hap i rëndësishëm në përmirësimin e infrastrukturës arsimore por edhe sigurimin e kushteve të përshtatshme mësimore dhe laboratorike për 2,400 studentë dhe 140 pedagogë. Universiteti Bujqësor i Tiranës, me 6,377 studentë në 5 fakultete dhe 78 programe studimi, synon të rrisë ndërkombëtarizimin dhe cilësinë e arsimit në fushat e bujqësisë, mjekësisë veterinare dhe bioteknologjisë.



Ndërkombëtarizimi i Universiteteve

Universiteti "Aleksandër Moisiu" në Durrës ka hapur tre programe të përbashkëta, me diploma të dyfishta me Universitetin "La Sapienza", Universitetin "Tor Vergata" dhe Universitetin e Gjenovës në Itali, që do të përfshijnë studime në të drejtë publike, studime europiane, dhe shkencë ndërkombëtare e diplomatike. Ministria Manastirliu tha se do të rritet mbështetja për insitucionet e arsimit të lartë, në kuadër të ndërkombëtarizimit të universiteteve.

2024, Viti i Gjuhës Shqipe

Në Ditën Ndërkombëtare të Arsimit, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ogerta Manastirliu, shpalli vitin 2024 si "Viti i Gjuhës Shqipe", duke nënvizuar rëndësinë e gjuhës dhe arsimit në zhvillimin e identitetit kombëtar shqiptar. Në kuadër të këtij viti të veçantë, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka planifikuar një sërë aktivitete, të cilat do të përfshijnë shkollat në të gjithë vendin, si dhe ato në diasporë. Kulmi i këtyre aktiviteteve do të jetë në 22 Nëntor, Ditën Kombëtare të Alfabetit Shqip, e cila për herë të parë do të festohet si festë zyrtare në vitin 2024.



Program Kombëtar për Zhvillimin Profesional të Mësuesve



Prezantohet Programi Kombëtar i Zhvillimit Profesional të Mësuesve 2024-2025. Programi i ri u prezantua në një aktivitet, ku merrnin pjesë Kryeministri Edi Rama, Ministria Ogerta Manastirliu, partnerë ndërkombëtarë, përfaqësues të institucioneve arsimore dhe mësues nga i gjithë vendi. Në kuadër të këtij programi të ri, më shumë se 16,000 mësues do të përfitojnë nga trajnime të specializuara në metoda inovative të mësimdhënies, me një fokus të veçantë në gjuhë, shkencë dhe aftësitë digjitale. Ministria Manastirliu prezantoi hapat e zbatimit të këtij program kombëtar. Do të ketë një kornizë të re të kualifikimit për mësuesit; Portofol Digjital i Mësuesit, një platforme interaktive të trajnimeve dhe një model të ri të shkollëve të kualifikimit të mësuesve, të shoqëruar me incentiva financiare.

KANTIERI I ARSIMIT, INVESTIME NË 100 SHKOLLA

Gjatë vitit 2024, Ministria e Arsimit dhe Sportit, në bashkëpunim me pushtetin vendor, si dhe përmes Programit të Rindërtimit të qeverisë shqiptare, të mbështetur nga partnerët ndërkombëtarë, është angazhuar për rindërtimin dhe rehabilitimin e 100 shkollave. Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ogerta Manastirliu ka ndjekur nga afër punimet në disa prej këtyre shkollave, konkretisht në shkollën "14 Nëntori" në Durrës, gjimnazin "Pjetër Budi" në Burrel, shkollën 9-vjeçare Lekaj në Rogozhinë dhe gjimnazin "Isa Boletini" në Vorë.



IMORE

2024-2025



MASTERPLAN PËR ZHVILLIMIN E INFRASTRUKTURËS ARSIMORE

Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Ogerta Manastirliu dhe Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, Arjan Mazniku, në një takim me kryetarët e bashkive, diskutuan rreth investimeve të reja për shkolla, palestera dhe terrene sportive. Me financimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, me buxhetin 2024 përfundojnë investimet në 30 shkolla dhe hapen kantieri të reja me një financim prej 1.3 miliard lekë. Ministria Manastirliu foli për një masterplan ambicioz që do të hartohet për zhvillimin e infrastrukturës arsimore.